

Data 10/10/2022

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës-PUNË

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROKURIMIT: “Qendra e monitorimit të trafikut (200 km) Faza e Parë”

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV): Stacion i monitorimit qëndror 33195200-5

VLERA E FONDIT LIMIT: 2,285,280,226.24 (dy miliard e dyqind e tetëdhjetë e pesë milion e dyqind e tetëdhjetë mijë e dyqind e njëzet e gjashtë pikë njëzet e katër) **Lekë pa TVSH.**
Në Euro: **19,570,782.10** (nëntëmbëdhjetë milion e pesëqind e shtatëdhjetë mijë e shatëqind e tetëdhjetë e dy pikë dhjetë) **EUR paTVSH.**

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor **Autoriteti Rrugor Shqiptar** ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kritereve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përbajtjen si më poshtë:

Procedura e prokurimit është e parashikuar në Buxhetin e Shtetit për vitin 2022 (Shkresa e MIE nr. 6498/4, datë 16.09.2022). Bazuar në Nenin 42, pika 1 e VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 “Autoriteti/enti kontraktor e ndan një kontratë në lote sa herë kjo është e mundur. Në çdo rast, duhet të përcaktohet qartë madhësia dhe objekti i këtyre loteve”. Në rastin konkret, teknikisht është e pamundur të ndahet në lote. Ndarja në lote e objektit do të komplikonte rakordimin e punimeve civile dhe proceseve të punës, e për pasojë do sillte risqe të mëdha, përfundimin e veprës në kohë dhe në cilësi.

Në zbatim të pikës 2 të Nenit 56 të Ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik” dhe pikës 3 të Nenit 24 të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”,

Autoriteti Kontraktor do të publikojë njoftimin e kontratës në gjuhën Angleze në gazetën “**TED**” me shpërndarje në Europë.

Në zbatim të pikës 2 nenit 12 të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, Autoriteti Kontraktor ka konvertuar vlerën limit të kontratës në Euro, sipas kursit zyrtar të këmbimit të Bankës së Shqipërisë data **10.10.2022, ora 12:24:52**

KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

- a. *Sigurim oferte, sipas Shtojcës 3;*
- b. *Formulari përbledhës i vetdeklarimit, sipas Shtojcës 8;*

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, dhe nenin 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, dhe nenin 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1 Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale: sipas shtojcës 8,

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

Operatori ekonomik duhet të ketë burime financiare të nevojshme për realizimin e objektit të prokurimit dhe merr përsipër çdo rrezik që mund të ndodhë, siç parashikohet apo nënkuptohet në kushtet e përgjithshme dhe të veçanta të kontratës. Në këtë kontekst, operatorët ekonomikë duhet të tregojnë se i përbushin kushtet e mëposhtme:

2.2.1 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim nga administrata tatimore, për xhiron vjetore për vitet financiare **2019, 2020, 2021**, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë **jo më e vogël se vlera e fondit limit** të parashikuar në njoftimin e kontratës.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë: *Lloji i procedure eshte "e hapur – Mbi kufirin e larte monetar", percaktimi i vleres se kerkuar eshte bere ne mbeshtetje te nenin 43, pika 2, germa "a" të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" ku percaktohet se: " dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës, në procedurat e prokurimit mbi kufirit të lartë monetar" eshtë percaktuar jo me e vogël se vlera e kontratës për të rritur numrin e konkurrenteve ne procedure*

Përcaktimi i viteve të kërkua e përcaktuar e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar eshte bere ne mbeshtetje te nenin 43, pika 1 " të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" ku percaktohet se: " Autoriteti/enti kontraktor, për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, kërkon kopje të deklaratave të xhiros vjetore të realizuar nga operatori ekonomik dhe, sipas rastit të xhiros që mbulon kontrata, për një periudhë maksimumi deri në 3 (tre) vitet e fundit financiare".

2.2.2 Për të vërtetuar një aktivitet pozitiv të qëndrueshëm, Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin bilancet vjetore, për vitet financiare **2019, 2020, 2021** ne perputhje me *nени 41 shkronja c*" të Ligjt nr. 1009/2009: "Personat juridikë që detyrohen për auditimin ligjor të pasqyrave financiare detyrohen të kryejnë auditimin ligjor të pasqyrave financiare vjetore, përpara publikimit të tyre, nga ekspertë kontabël ose shoqëri audituese, **ku bilancet e dy viteteve të njëpasnjëshme, nuk duhet të kenë raport negativ ndërmjet aktivit dhe pasivit.**

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenit 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik".

Përcaktimi i viteve të kërkua e përcaktuar e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, si dhe kërkeseve të ligjit Nr. 25/2018 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare". Referuar në nenin 29 të Ligjt Nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat tatile: "Çdo tatimpagues përgatit deklaratën vjetore të të ardhurave të tatushme në formën e përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të ketij ligji. Tatimpaguesit paraqesin deklaratën vjetore në organet tatile brenda datës 31 mars të vitit pasardhës, duke paraqitur në të njejtën kohë bilancin kontabël, së bashku me anekset e tij, si dhe çdo të dhëne tjetër të përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të ketij ligji.

Ndërsa shoqërimi me Akt Ekspertizen e Ekspertit Kontabel te Autorizuar, është bërë duke iu referuar parashikimit në nenit 41 shkronja c" të Ligjt nr. 1009/2009: "Personat juridikë që detyrohen për auditimin ligjor të pasqyrave financiare detyrohen të kryejnë auditimin ligjor të pasqyrave financiare vjetore, përpara publikim të tyre, nga ekspertë kontabël ose shoqëri audituese: "c) shoqëritë me përgjegjësi të kufizuar, të cilat zbatojnë për raportimin financiar standardet kombëtare të kontabilitetit, kur, në mbyllje të periudhës kontabël, për dy vite radhazi, tejkalojnë **dy prej tre treguesve të mëposhtëm:** i) totali i aktiveve të bilancit, në mbyllje të periudhës kontabël përkatëse, arrin ose e kalon shumën prej **50 milionë lekësh;** ii) shuma e të ardhurave nga veprimtaria ekonomike (qarkullimi) në atë periudhë kontabël arrin ose e kalon shumën prej **100 milionë lekësh;** iii) ka, mesatarisht, **30 të punësuar gjatë periudhës kontabël**".

2.3 Kapaciteti teknik:

Operatori Ekonomik duhet të përmbushë kërkesat e mëposhtme minimale përsa i përket aftësisë teknike e profesionale

2.3.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për përvojën e mëparshme të ngjashme

a) punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se **50%** e vlerës së përllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar **gjatë pesë viteve të fundit**, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, ose

b) punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë **pesë viteve të fundit**, është jo më e vogël se **dyfishi** i vlerës limit të kontratës që prokurohet.

Plotesimi i njerit prej dy kushteve te siperpermendura e ben oferten te kualifikueshme.

Pika 2.3.1/a plotësohet nga anëtarë i cili ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim. Anëtarët e tjerë të bashkimit do të paraqesin kontratat e ngjashme në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim. Në rastin kur operatoret ekonomik, anëtarë të një bashkimi, kanë të njëjtën përqindje pjesmarje në bashkim, vendosin me marreveshje në kontratën e bashkëpunimit se cili prej tyre do të permbohet këtë kusht. Kurse pika 2.3.1/b duhet të plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.

2.3.1/1 Vlerësimi i përvojës së suksesshme të Operatorit Ekonomik do të kryhet bazuar në deklaratat e dokumentat e mëposhtme:

a) Për kontrata të realizuara me ente publike operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm:

- Formular vlerësimi per realizimin e punimeve sipas shtojcës Nr. 9, shoqëruar me:
- Kontratë Sipërmarrje
- Situacionin përfundimtar;
- Faturat tatimore,
- Aktin e kolaudimit;
-

Shënim: Formulari i vlerësimit duhet të përcaktojë saktësisht cilësinë e kryerjes së punëve, dhe faktin nëse kontrata është realizuar me sukses.

b) Për kontrata të realizuara me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm:

- vertetim leshuar nga subjekti privat shoqëruar me:
- Kontrate Sipërmarrje;
- Situacionin përfundimtar;
- faturat tatimore
- Akt kolaudimi objekti;

2.3.1/2 Per kontratat e realizuara si Bashkim Operatoresh, operatori ekonomik ofertues duhet te paraqesë: Kontraten e bashkimit te operatoreve dhe prokuren e posacme te deklaruara ne fazen e tenderimit;

2.3.1/3 Per kontratat e realizuara si Nënkontraktor, operatori ekonomik ofertues duhet te paraqesë: Kontratën baze ndermjet Kontraktorit dhe Autoritetit Kontraktor; si dhe Miratimi zyrtar si nenkontraktor i deklaruar nga ana e autoritetit kontraktor.

Shënim: *Vertetimi duhet te percaktoje saktësisht cilësinë e kryerjes se punëve, dhe faktin nëse kontrata eshte realizuar me sukses.*

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuare bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 5 (ose në rastin e procedurave të thjeshtuara në nenin 55, pika 4), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që punët e mëparshme të ngashme të janë minimalisht në vlerat..50 % të vlerës së fondit limit, për një objekt të vetëm, ose minimalish sa dyfishi i fondit limit, për punët totale të ngashme të kryera në 5 vitet e fundit, që janë brenda vlerave kufi të përcaktuara në nenin e sipërcituar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngashme argumentohet si më poshtë: Përvoja e mëparshme është element shumë i nevojshëm që garantojnë autoritetin, se operatorët ekonomikë mbi bazën e vlerës së punëve të ngashme zotërojnë kapacitete për të zbatuar kontratën me sukses sipas një standarti të përshtatshëm cilësie. Në mbështetje të nenit 88 pika 1 e VKM 285/2021, parashikon se “Oferta mund të paraqitet nga një bashkim operatorësh ekonomikë, sipas përcaktimit të pikave 2 dhe 3, të nenit 14, të LPP-së, ku njëri prej të cilëve i përfaqëson të tjerët gjatë procedurës dhe, në rast përgjedhjeje, edhe gjatë zbatimit të kontratës. Në ofertë duhet të përcaktohet pjesa e shërbimit, punës ose furnizimit, që do të kryejë secili nga anëtarët e këtij bashkimi nëpërmjet një kontrate bashkëpunimi të hartuar ndërmjet palëve.

2.3.2 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin licencën profesionale të shoqërisë, të vlefshme për zbatimin e punimeve objekt kontrate, të lëshuar nga Ministria e Infrastrukturës dhe Enerjisë, sipas formatit të miratuar me *Vendim të Këshillit të Ministrave nr. 42, datë 16.01.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”*. Shqyrtimi i licencave do të bëhet mbi bazën e rregullave të parashikuara sa më sipër. Licenca profesionale e

Operatorit Ekonomik lidhur me ekzekutimin e punëve të kontratës duhet të përmbajë kategoritë e mëposhtme:

Nr.	Licenca	Kategoria e kryerjes së punimeve
1	NP-1-A	Punime gjermimi në tokë.
2	NP-4-D	Rrugë autostrada, ura, mbikalime, hekurudha, linja tramvaji, metro, hekurudhë me kavo dhe pista aeroportuale.
3	NP-11-D	Ndërtimë për nënstacionet, kabinet e transformatorëve, linja e tensionit të lartë e të mesëm dhe shpërndarjen e energjisë.
4	NP-12-A	Punime të inxhinierisë së mjedisit.
5	NS-5-A	Impiantë të sinjalistikës ndriçuese të trafikut.
6	NS-7-A	Barriera dhe mbrojtje rrugore.
7	NS-13-B	Impiantë dhe linja telefonie dhe telekomunikacioni.
8	NS-14-C	Impiantë të brendshme, elektrike, telefoni, radiotelefoni TV etj.
9	NS-18-A	Punime topogeodezike.

Shoqëritë e huaja duhet të bëjnë ekuivalentimin e licencave profesionale që disponojnë të lëshuara nga vendi i origjinës, pranë Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, Republika e Shqipërisë. (Rregullorja për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi, e miratuar me VKM-në nr.42, datë 16.01.2008). Mosparaqitura në këtë formë është kusht skualifikues.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, Nenin 39, pika 6/a, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, si dhe Vendim te Keshillit te Ministrave Nr. 42 date 16.01.2008, “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”. Gjithashtu, të dhënat për licencat e mësipërme janë vendosur referuar bazës ligjore për ndërtimet, Ligji nr. 8402 datë 10.9.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit” të ndryshuar, Neni 8 përcakton “Zbatimi i punimeve të ndërtimit kryhet vetëm nga persona juridikë, privatë ose publikë, vendas ose të huaj, të pajisur me licencën përkatëse, për zbatim punimesh ndërtimore. Zbatuesi i punimeve mban përgjegjësi dhe është i detyruar të realizojë punimet e ndërtimit, në përputhje me lejen e ndërtimit, projektin, kushtet teknike të zbatimit dhe rregullat e sigurimit teknik. Ai duhet të sigurojë cilësinë e materialeve të ndërtimit

dhe produkteve të ndërtimit, të cilat duhet të plotësojnë kërkesat e projektit në përputhje me standartet kombëtare ose europiane”.

Kategoritë e kërkuar janë kërkuar bazuar në zërat dhe vlerat e punimeve, si më poshtë:

Kategoria e kërkuar	Përshkimi i kategorisë sipas legjisacionit të fushës	Zërat e punimeve që parashikohen të kryhen në preventiv, që përfshihen në kategorinë përkatëse	Niveli i klasifikimit i kërkuar për kategorinë respektive në milion lekë	Vlera e punimeve që parashikohen të kryhen në preventiv, që përfshihen në kategorinë përkatëse
NP-1-A	Punime gërmimi në tokë.	Gëermim dheu + Gërmim themeli + Gërmim traseje	0-20	18,473,741
NP-4-D	Rrugë autostrada, ura, mbikalime, hekurudha, linja tramvaji, metro, hekurudhë me kavo dhe pista aeroportuale.	Totali i punimeve në rrugë	101-200	180,715,429
NP-11-D	Ndërtime për nënstacionet, kabinat e transformatorëve, linja e tensionit të lartë e të mesëm dhe shpërndarjen e energjisë.	Sinjale Semaforësh + Tabela Elektronike + Gjenerator	101-200	177,691,750
NP-12-A	Punime të inxhinierisë së mjedisit.	10% e shumës totale të punimeve në rrugë	0-20	18,071,542
NS-5-A	Impiante të sinjalistikës ndriçuese të trafikut.	Sinjal Semaforësh + Kontrolli i Sinjaleve	0-20	8,249,472
NS-7-A	Barriera dhe mbrojtje rrugore.	Guardrail + Fundore Guardrail + Montim, cmontim i trafikndaresve	0-20	6,111,254
NS-13-B	Impiante dhe linja telefonie dhe telekomunikacioni.	IP Phones Telefonat IP Sistemet e Telefonave Emergjence	21-50	48,146,918
NS-14-C	Impiante të brendshme, elektrike, telefoni, radiotelefoni TV etj.	Përfshihen të gjitha elementet pasive (total kapitulli)	51-100	88,689,370
NS-18-A	Punime topogjeodezike.	10% e shumës totale të punimeve në rrugë	0-20	18,071,542

2.3.3 Operatori ekonomik pjesëmarrës për realizimin e punimeve objekt kontrate, duhet të disponojë fuqi punëtore minimalisht **270 (dyqind e shatëdhjetë) persona**. Për përbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë disponimin e numrit minimal të punonjësve për periudhën **Prill 2022 - Shtator 2022**, në formularin përbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës nr. 8. “*Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese*”.

Këto dokumente duhet të paraqiten në original ose në kopje të njehsuara me originalin, si më poshtë:

- Vërtetim të lëshuar nga Sigurimet Shoqërore ose Administrata Tatimore sipas formatit që kërkohet nga legjislacioni në fuqi, ku të specifikohet numri i punonjësve për secilin muaj, për periudhën **Prill 2022 - Shtator 2022**.
- Listëpagesat e punonjësve sipas formatit që kërkohet nga legjislacioni në fuqi për periudhën **Prill 2022 - Shtator 2022**.

Argumentim: Autoriteti Kontraktor këtë kriter e ka bazuar në nenin 77, pika 4 të Ligjit nr.162 datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” në të cilin thuhet: “*Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës*”.

Numri i punonjësve është përcaktuar bazuar në afatin, orët e punës dhe pagen minimale te lejuar, që duhen për të përbushur zbatimin e kontratës. Numri i punonjësve dhe qëndrueshmëria e tyre në punë me kohështrirje **Prill 2022- Shtator 2022**, tregon besueshmëri për autoritetin. Dëshmia e kërkuar për numrin e fuqisë punëtore të operatorit ekonomik e nevojshme për ekzekutimin e objektit të kontratës, është dokument që vërteton kapacitetin teknik dhe profesional të operatorit, përsa kohë që ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës. Deklarimi dhe regjistrimi i punonjësve në regjistrin e sigurimeve është një detyrim ligjor i punëdhënësit e parashikuar nga Kodi i Punës, për rrjedhojë çdo dëshmi me këtë kohështrirje është dokument vërtetues për qëndrueshmërinë e të punësuarve dhe përvojën e tyre, për sa kohë që ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës. Punësimi i një numri të caktuar, si një nga kërkesat themelore të kualifikimit, përveç besueshmërisë së operatorëve ekonomik, përpinqet të kufizojë edhe problematikat sociale dhe shhangjen e informalitetit në tregun e punës, po ashtu është një tregues i kualifikimit dhe eksperiencës që duhet të ketë kjo kategori e punonjësve. Vendosja e kriterit për një punësim te paktën **270 persona** duke përfshire dhe stafin teknik, është në përputhje me volumin e punës, natyrën dhe terrenin ku do të kryhen punimet. Po t'i referohemi projektit, preventivit, relacionit, matjeve përkatëse që ka bëre projektuesi është plotësisht i justifikuar numri i punonjësve. Kriteri për kualifikim është vendosur që t'i shërbejë autoritetit për të njobur gjendjen e kapaciteteve të operatorëve të cilët nëpërmjet dokumentacionit të vërtetojnë se zotërojnë, kapacitetet teknike dhe profesionale, personelin e nevojshëm, si dhe kapacitetet organizative, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

Analizat teknike janë bazuar ne VKM nr. 629, datë 15.7.2015 “Për miratimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe të analizave teknike të tyre” (Ndryshuar me VKM nr. 631,

datë 26.10.2018) Bazuar ne kater elementet e strukturese se kostos (material, puntori, makineri, transport) zeri fuqi puntore ze rreth 10-20% te kostos.

2.3.4 Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e punimeve objekt kontrate, duhet të disponojë **personelin kryesor, drejtues teknik në licencën e shoqërisë**, si më poshtë:

- **1 (një) Inxhinier Ndërtimi**
- **1 (një) Inxhinier Elektrik**
- **1 (një) Inxhinier Gjeolog/ Gjeoteknik**
- **1 (një) Inxhinier Mjedis**
- **1 (një) Inxhinier Elektronik**
- **1 (një) Inxhinier Topograf / Gjeodet/ Markshaider**
- **1 (një) Inxhinier Mjedisi**

Për secilin pjesëtar të stafit teknik të mësipërm duhet të paraqesë: Kontratë pune e vlefshme, Diplomë, Librezë pune dhe CV (Drejtuesit teknik të jenë të siguruar sipas legjislativit në fuqi)
****Kriteri konsiderohet i përbushur me vetëdeklarimin sipas Formularit Përbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës nr 8. “Përpara publikimit të njofimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari dorëzimin e dokumenteve provuese. Këto dokumente duhet të paraqiten në original ose në kopje të njehsuara me originalin.*

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/c), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Kriteri për stafin drejtues teknik, lidhet ngushtësisht me objektin e kontrates, relacionin teknik dhe zërat e punimeve. Nevoja për inxhinierët në objekt është e diktuar nga përvoja dhe legjislationi për punimet e ndërtimit. Mungesa e këtij stafi pothuajse në çdo rast rezulton në realizim jashtë afatit, jashtë normave dhe me cilësi të dobët të objekteve. Numri i stafit kryesor teknik është përcaktuar nga pikëpamja e natyrës teknike të kontratës me qëllimin për të patur një rezultat sa më të mirë në mbarëvajtjen dhe zbatimin e punimeve. Operatorët ekonomikë duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën. Drejtuesi i projektit është përgjegjës për ndërtimin në përputhje me kushtet teknike të zbatimit, sigurimin teknik dhe mbrojtjen në punë brenda kushteve të kontratës.

2.3.5 Operatori ekonomik, për realizimin e punimeve objekt kontrate, duhet të disponojë edhe stafin mbështetës (jo domosdoshmërisht drejtues teknik në licencën e shoqërisë), si më poshtë:

- **1 (një) Inxhinierë Ndërtimi**
- **1 (një) Inxhinier Ndërtimi (Profil Profili Transport)**
- **1 (një) Inxhinier Mekanik**
- **8 (tetë) Inxhinier Elektronik/ Informatik/ Informatikë Teknologjike/ Shkenca kompjuterike**

Për secilin pjesëtar të stafit teknik të mësipërm duhet të paraqesë: Kontratë pune e vlefshme, Diplomë, Librezë pune dhe CV.

*** *Kriteri konsiderohet i përbushur me vetëdeklarimin sipas Formularit Përbledëes të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës nr 8. "Përpala publikimit të njofimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari dorëzimin e dokumenteve provuese". Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njehsuara me origjinalin.*

- ❖ **Stafi i kërkuar në pikën 2.3.5 nuk duhet të jetë i angazhuar në kontrata të tjera, apo të deklaruara në procedura të shpallura fituese.**

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik" dhe Nenit 39, pika 6/c) të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Kriteri për stafin mbështetës lidhet ngushtësisht me objektin e kontratës, termat e referencës dhe preventivin paraprak. Nevoja për inxhinierët në objekt është e diktuar nga përvoja dhe legjislacioni për punimet e ndërtimit. Mungesa e këtij stafi pothuajse në çdo rast rezulton në realizim jashtë afatit, jashtë normave dhe me cilësi të dobët të objekteve. Numri i inxhinierëve të ndërtimit, është përcaktuar nga pikëpamja e natyrës teknike të kontratës me qëllimin për të patur një rezultat sa më të mirë në mbarëvajtjen dhe zbatimin e punimeve. Operatorët ekonomikë duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën. Drejtuesi i projektit është përgjegjës për ndërtimin në përputhje me kushtet teknike të zbatimit, sigurimin teknik dhe mbrojtjen në punë brenda kushteve të kontratës.

2.3.6 Operatori ekonomik ofertues duhet disponoje punonjës të specializuar / kualifikuar si më poshtë:

- 1 (një) punonjës i pajisur me certifikuar "**Ekspert për ndihmën e parë dhe ndërhyrjen ndaj emergjencave**", e cila të jetë e lëshuar nga shoqëri të akredituara ose nga organizma ndërkombëtare akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë.

- 1 (një) punonjës që disponon certifikatën si “**Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë**” në përputhje me klauzolat e Ligjit nr. 10327, datë 18/02/2010 “Për sigurinë dhe shëndetin në punë” dhe V.K.M-së nr. 312, datë 05.05.2010 “Për miratimin e rregullores “Për sigurinë në kantier”.
- 1 (nje) “**Ekspert Zjarrfikës**” me certifikaten perkatese lëshuar nga Drejtoria e MZSH-së/ license per mbrojtje nga zjarri, te leshuar nga QKL, Kodi I.2.A.

Për përbushjen e këtij kriteri operatori duhet të paraqesë Diplomë/Certifikatat e cituara më sipër.

*** *Kriteri konsiderohet i përbushur me plotësimin e formularit përbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës nr. 8. “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese”. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njehsuara me origjinalin.*

Argumentimi: Në bazë të VKM Nr.815, datë 23.11.2011 PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR.153, DATË 7.4.2000 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE "PËR MIRATIMIN E RREGULLORES SË ZBATIMIT TË KODIT RRUGOR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË", TË NDRYSHUAR. Neni 71/1 Auditimi i sigurisë rrugore (Neni 35 i Kodit Rrugor) “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Konkretisht:

Kërkesa e mësiperme mbështetet në ligjin Nr. 10327 datë 18/02/2010 “Për sigurinë dhe shëndetin në punë” dhe V.K.M nr. 312, datë 05.05.2010 “Për miratimin e rregullores “Për sigurinë në kantier” si dhe ligjit Nr. 10431 datë 09.6.2011 “Për mbrojtjen e mjedisit”. Natyra e kontratës dhe specifikat e sajë kërkojnë njohuri e përgatitje të posaçme për vlerësimë të përpikta për të zgjidhur çështje që lidhen me garantimin e sigurisë dhe mbrojtjen në punë. Në rregulloren për sigurinë në kantier miratuar me VKM nr.312/2010 është përcaktuar se punëdhënësi për mbrojtjen dhe parandalimin nga rreziqet, duhet të ndjekë kurse formimi përkatës në fushën e sigurisë e të shëndetit në vendin e punës. Çdo punëdhënës zgjedh një ose disa persona si përgjegjës për ndihmë e parë në rast emergjencash dhe për sigurinë e mbrojtjen e shëndetit. Rregullorja përcakton kërkuesat minimale të sigurisë dhe të shëndetit në punë për kantieret e përkohshëm ose të lëvizshëm, si dhe masat e përgjithshme të mbikëqyrjes.

Operatori/ët ekonomik/ë, që gjatë kryerjes së ushtrimit të veprimtarisë, duhet të ketë/në kualifikimet dhe dokumentat përkatësë lidhur me ndikimin në mjedis dhe rehabilitimit të mjedisit, për raste ndotjesh siç parashikon VKM-ja nr.312/2010. Rregullat dhe procedurat e përgjithshme për garantimin e mbrojtjes në një nivel të lartë të mjedisit janë detyrim ligjor për çdo subjekt tregtar person fizik apo juridik për parandalimin dhe pakësimin e rreziqueve ndaj jetës e shëndetit të njeriut, sigurimin dhe përmirësimin e cilësisë së jetës, në dobi të brezave të sotëm dhe të ardhshëm, si dhe sigurimin e kushteve për zhvillimin e qëndrueshëm të vendit. Garantimi i ekspertizës së mbrojtjes nga çdo rrezik dhe të papritur në punë dhe dokumentat përkattëse të personave përgjegjës i shërbejnë autoritetit për të krijuar bindjen dhe besueshmëri për realizimin e kontratës.

Kërkesa per sherbimin e mbrojtjes nga zjarri mbështetet sipas Ligjit Nr. 152/2015 "Per sherbimin e mbrojtjes nga zjarri dhe per shpetimin"

2.3.7 Kandidati ofertues duhet të përcaktoje me anë të një **deklaratë** (nga Administratori i shoqërisë) **Drejtuesin Teknik të punimeve** (inxhinier me eksperience) në objekt, i cili duhet të

jetë i perfshire ne licencen e shoqerise dhe të deklaroje se do të jetë i pranishëm gjatë gjithë kohës që do të kryhen punimet në objekt,

Kriteri konsiderohet i përbushur me paraqitjen e formularit të vetëdeklarimit sipas shtojcës 8.

“Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese., si më poshtë: diplome, libreze pune dhe kontrate pune.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/c), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, si dhe bazuar ne ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve në ndërtim” e ndryshuar me ligjin nr.120/2020 “Per disa ndryshime dhe shtesa” me anë të këtij kriteri kërcohët që operatorët ekonomikë të përcaktoje Drejtuesin Teknik që do jetë i pranishem gjatë gjithe kohes në object.

2.3.8 Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e kontratës, duhet të disponojë, mjetet dhe pajisjet e mëposhtme:

Nr	Emri i mjetit	Njesi	Sasi	Statusi
1	Kamion vetëshkarkues me kapacitet mbajtës mbi 20-ton	Copë	3	Në pronësi ose me qera
2	Kamion vetëshkarkues me kapacitet mbajtës mbi 10-20 ton	Copë	3	Në pronësi ose me qera
3	Kamionçinë	Copë	1	Në pronësi ose me qera
4	Automjet me vinç me kosh për punime në lartësi	Copë	2	Në pronësi ose me qera
5	Autobot uji	Copë	2	Në pronësi ose me qera
6	Autobetoniere	Copë	4	Në pronësi ose me qera
7	Autopompë betoni	Copë	2	Në pronësi ose me qera
8	Autovinç	Copë	2	Në pronësi ose me qera
9	Fadromë me goma	Copë	3	Në pronësi ose me qera
10	Autobitumatriçe	Copë	1	Në pronësi ose me qera
11	Greider	Copë	2	Në pronësi ose me qera
12	Minifadromë	Copë	2	Në pronësi ose me qera

13	Minieskavator	Copë	2	Në pronësi ose me qera
14	Rrul asfalti	Copë	2	Në pronësi ose me qera
15	Gjenerator	Copë	2	Në pronësi ose me qera
16	Batipal	Copë	1	Në pronësi ose me qera
17	Makineri vijëzimi	Copë	1	Në pronësi ose me qera

Kriteri konsiderohet i përbushur me paraqitjen e formularit të vetëdeklarimit sipas shtojcës 8. “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin, si më poshtë:

- Për mjetet që shënohen në regjistra publikë, kur jane ne pronesi, duhet të paraqitet dokumentacioni që verteton pronesine e mjetit: çertifikaten e pronesise; leja e qarkullimit; çertifikaten e kontrollit teknik; siguracionin; leja e transportit që leshohet nga njesia vendore dhe fotot perkatese;
Ndersa per mjete te marra me qira krahas dokumentacionit te mesiperm, duhet te paraqitet edhe kontrata e qirase, e cila duhet te jete e vlefshme per te gjithe periudhen deri ne perfundimin e plote te punimeve.
- Për mjetet që nuk shënohen në regjistra publikë, kur jane ne pronesi, duhet të paraqitet kontrata e blerjes ose fatura e zhdoganimit ose fatura tatimore perkatese, fotot, ndersa per mjete te marra me qira krahas dokumentacionit te mesiperm, duhet te paraqitet edhe kontrata e qirase e cila duhet te perfshije objektin perkates dhe duhet te jete e vlefshme per te gjithe periudhen deri ne perfundimin e plote te punimeve.
- Për nyjen e prodhimit të inerteve dhe nyjen e prodhimit të betonit të paraqiten dokumentat e pronesise ose kontratën e qerasë ose kontrata e furnizimit si dhe leje mjedisore Kodi. III.1.B lëshuar nga QKL.
- Operatori ekonomik duhet të paraqesë foto për secilin mjet të deklaruar ku të jetë e dukshme dhe targa e mjetit.
- Makineritë e mësipërme nuk duhet të jenë të angazhuara në kontrata të tjera apo të deklaruara ne procedura te shpallura fitues.

Autoriteti Kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik si më sipër, ose t'i kërkojë operatorit sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime, në përpjekje me nenin 26, pika 7, të VKM nr.285, datë 19.05.2021, “Për Miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik”.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/c dhe 6/d, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021“Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë mjetet e pajisjet teknike, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të

prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përbushur kontratën.

Për të përcaktuar numrin e mjeteve/makinave të nevojshme për realizimin e kontratës, janë hartuar analizat teknike, sipas legjisacionit të fushës *bazuar ne VKM nr. 629, datë 15.7.2015 “Përmiratimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe të analizave teknike të tyre”* (*Ndryshuar me VKM nr. 631, datë 26.10.2018*).

2.4 Kërkesa të tjera të veçanta për kualifikim

2.4.1 Operatori/et ekonomik duhet të paraqesin çertifikatat e cilësisë së punimeve, të vlefshme (ose ekuivalente) per objektin qe prokurohet, si me poshte

- | | |
|-------------------|---|
| - ISO 9001:2015 | Sistemet e Menaxhimit të Cilësisë |
| - ISO 14001:2015 | Sistemet e Menaxhimit Mjedisor |
| - ISO 45001: 2018 | Menaxhimi i Shëndetit dhe Sigurisë në Punë |
| - ISO 50001: 2011 | Sistemet e Menaxhimit të Energjisë |
| - ISO 27001: 2013 | Sistemet e Menaxhimit të Sigurisë Informatike |
| - ISO 39001: 2012 | Sistemet e Menaxhimit të Sigurisë Rrugore |

Të gjitha çertifikatat e mësipërme duhet të jenë të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njojur nga Republika e Shqipërisë. Në rastet e Bashkimit te Operatorëve ekonomik çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë çertifikatën e mësipërme sipas zërave të punimeve që do të realizojë.

Argumentimi: Kerkesat e mesiperme janë vendosur bazuar ne Nenin 79, pika 1 te Ligjit Nr. 162/2020, “Per prokurimin publik”, sipas të cilit: “Autoriteti ose enti kontraktor për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t'u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njojur nga Republika e Shqipërisë”, si dhe ne zbatim te Neni 44, pika 1 dhe pika 3 të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, ku përcaktohet se: “Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t'u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njojur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit”

2.4.2 Grafiku i punimeve.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 79, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Per prokurimin publik”, nenin 39, pika 3 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”

2.4.3 Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë deklaratën ku të shprehet se është dakort me mënyrën e financimit të objektit dhe se punimet për realizimin e këtij objekti do të përfundojnë brenda afatit të përcaktuar nga autoriteti kontraktor (në rast të shpalljes fitues). Paraqitja e kësaj deklarate është kërkuar, pasi burimi i financimit për këtë procedurë është Buxheti i Shtetit, e përcaktuar edhe te pika 2.10 e DST-ve. Financimi është parashikuar në buxhetin 2022-2024, por vlera e parashikuar e kontratës kalon 3 (tre) vjeçarin, edhe pse afati i realizimit është sipas grafikut të punimeve.

Autoriteti Kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik si më sipër, ose t'i kërkojë operatorit sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime, në përputhje me nenin 26, pika 7, të VKM nr.285, datë 19.05.2021, “Për Miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik”.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.

Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

Argumentimi i specifikimeve teknike

Shënim: Përcaktoni specifikimet teknike, për punimet objekt prokurimi, të cilat duhet të shprehin qartë kérkesat e autoritetit/entit kontraktor për cilësinë e të gjitha punimeve dhe të materialeve që do të përdoren, si dhe kérkesa të tjera që lidhen ngushtë me natyrën dhe përbërësit e projektit të punës, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 39, pika 2, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, duke argumentuar çdo kérkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.

Kujdes: Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të nenit 36, të LPP. Referime të tillë duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.